



Titulli i projektit

Ngritja e Qendrës së Informimit të Fermerëve

Tipi i projektit

Zhvillimi i sektorit strategjik të bujqësisë

Vendndodhja e projektit

Koplik - Zona funksionale Malësi e Madhe

Buxheti i paravlerësuar

15,000 Euro në vit

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Analiza ekonomike e programit të zonës funksionale ka nxjerrë në pah një numër problematikash, që deri më tani kanë penguar shfrytëzimin e potencialit të të ardhurave të sektorit bujqësor në Malësi të Madhe. Një pjesë e tyre lidhet me tregun, me mungesën e informacionit mes fermerëve mbi mundësitë për diversifikim të fermave, apo përparësinë që kanë farat autoktone dhe natyrale. Ngritja e një qendre informimi dhe drejtimi për fermerët është një projekt- ide që vjen në përgjigje të nevojës për të zgjidhur këto problematika dhe për të lejuar zgjerimin e prodhimit bujqësor që gjen treg më të gjerë rajonal, apo dhe ndërkufitar.

Qëllimi/et specifik të projektit

Objekti i projektit është mbështetja e fermerëve të zonës funksionale Malësi e Madhe me informacion në lidhje me tregun vendas e të huaj, si dhe me mundësitë për përfitim të fondeve financiare për investime të nevojshme në përgjigje të kërkesës së tregut. Marrja e informacionit të saktë është një element i rëndësishëm për të riorganizuar sektorin e bujqësisë, që është sektori parësor strategjik për zonën, në mënyrë të tillë që të shfrytëzohen avantazhet konkurruese dhe potenciali i të ardhurave.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Rezultatet e pritshme të projektit janë:

- fermerë të informuar mirë mbi potencialet afatgjata dhe të qëndrueshme të zhvillimit të fermave të tyre, si dhe për mundësitë që ofron toka bujqësore aktualisht e pa kultivuar,
 - rishpërndarje e sipërfaqeve të kulturave që mbillen aktualisht në Malësi të Madhe.
- Përfitues të drejtpërdrejtë janë fermerët e zonës funksionale, e cila numëron aktualisht rreth 8,222 ferma, kryesisht familjare. Nga ana tjetër, përfitues janë të gjithë banorët e zonës funksionale, rreth 54,555, duke pasur parasysh se bujqësia është veçuar si sektori primar për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të saj.

PROJEKTI 2



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

Aktivitetet kryesore të projektit për ngritjen e qendrës së informimit të fermerëve janë:

1. Rregullimi i kuadrit ligjor nën të cilin do të funksionojë kjo qendër informimi për zonën funksionale Malësi e Madhe;
2. Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e saj (ambienti, mjetet e punës);
3. Ngritja e një grupi specialistësh të sektorit të bujqësisë, si dhe stafit operativ të qendrës;
4. Organizimi i një fushate informimi mbi hapjen e kësaj qendre dhe qëllimin e saj.

Maturimi i projektit

Ngritja e një qendre informimi për fermerët është një projekt-ide, e cila ka për bazë nevojat e gjetura nga analiza ekonomike e programit të zonës funksionale dhe rekomandimet e dhëna, të miratuara gjithashtu nga ekspertë të fushës së bujqësisë në Malësi të Madhe. Si një aktivitet kyç paraprak për realizimin me sukses të projektit, mund të veçohet hartimi i një plani për zgjerimin e tokës bujqësore aktualisht të pakultivuar, si dhe shfrytëzimin sa më efektiv të pjesës së kultivuar, në bazë të studimit të tregut rajonal dhe ndërkufitar. Informimi e drejtimi i fermerëve të zonës funksionale sipas një plani paraprak, hedh gjithashtu bazat për bashkëpunim mes tyre.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Donatorë të mundshëm të projektit janë identifikuar: Ministria e Bujqësisë dhe Shoqata e Fermerëve, të cilët janë të lidhur drejtpërdrejtë me zhvillimin e bujqësisë dhe kapaciteteve njerëzore në këtë drejtim.

Kostot e projektit

Elementet bazë të kostonë së këtij projekti janë pagat e konsulentëve dhe organizatorëve të tij, si dhe një fond fillestar për sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për ngritjen e qendrës.

Kostoja e vitit të parë të qendrës vlerësohet në 20,000 Euro, ku përfshihet edhe kosto e infrastrukturës, ndërsa në vitet në vijim kostonë e pritshme janë 15,000 Euro në vit.